

The Foundation Cultural Heritage without Borders (CHwB) was constituted in April 1995 as a reaction to the acute and massive aid that was needed due to the war in Bosnia-Herzegovina. Destruction of cultural monuments was quite extensive and systematic, which made the world realise the urgent need for development assistance and protection. When a group of architects and conservation workers in Sweden gathered to protest, discussions were held to find ways to take concrete action and to suggest proposals for financing Swedish emergency aid in this area within the framework for Sida's development co-operation.

Within this group of founding members the appropriate documents and statutes were drawn up for a foundation whose aims were broadened to include not just urgent action in the former Yugoslavia but also to "promote conservation of cultural property in areas ravaged by armed conflict, catastrophes or otherwise endangered as well as stimulate appropriate research."

A question of feeling at home

The right to one's own cultural heritage is an integral part of human rights. In today's world where a large number of people lives in another place than their original home, working with cultural heritage offers a daunting challenge.

Time after time we have witnessed the way war, political conflicts, natural catastrophes, climate changes and neglect deprive different ethnic groups of their cultural heritage and history. Modern warfare has become all the more brutal in its attacks on civil population, brazen examples of which have been the desecration and destruction of cultural monuments of the enemy. This has been seen in the Balkans, the Middle East and Asia. However, there is considerable evidence that working with the conservation and development of historic environments can help promote the process of reconciliation, strengthen self-belief, contribute towards growth and fight poverty.

Cultural Heritage without Borders was founded in 1995 as an independent Swedish non-governmental organisation to work in the spirit of the 1954 Hague Convention for the protection of cultural property in the event of armed conflict, natural catastrophes, neglect, poverty or political and social conflicts. Rebuilding and protection of cultural symbols is viewed by Cultural Heritage without Borders as one of the conditions for people to feel at home and secure, especially after a war or conflict waged on ethnic grounds.

So far most of the work conducted by Cultural Heritage without Borders has been in the former Yugoslavia with building restoration, museum developments and work exchanges. In addition, Cultural Heritage without Borders has participated in the restoration of a Tibetan monastery in Gandze in the province of Sichuan in China.

In all these projects priority has been given to use the same material and techniques as was used in the original building and to ensure that most of the work was implemented by local and national partners.

Since working with cultural heritage helps victimised groups strengthen and regain their sense of pride, the aim has been to integrate restoration and development of cultural property into the normal emergency relief work and development co-operation and therefore to improve the conditions for reconciliation and poverty reduction. A longterm hope is that several more international organisations will be able to collaborate together in such a concrete and practical way.

We would like to extend our warm thanks to our supporters, individual donors as well as Swedish International Development Cooperation Agency (Sida) and EU, without whose help none of our work would have been possible...

Stockholm, November 2005

Bengt O. H Johansson (Chairman)

**FOUNDATION FOR CULTURAL HERITAGE
WITHOUT BORDERS - SWEDEN,
KOSOVO OFFICE**

address: R. Zogovic, Payton City-10000 Prishtina, Kosovo
tel & fax: +381 38 243 918
e-mail: kosovo@chwb.org
web: www.chwb.org, www.chwb.org/kosovo

Fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) u themelua në prill të vitit 1995, si reagim ndaj ndihmës akute dhe masive që kërkohej si rezultat i luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë. Shkatërrimi i monumenteve të kulturës u bë në përmasa të mëdha dhe ishte sistematik, dhe kjo e bëri botën që të kuptojë nevojën urgjente për ndihmë në zhvillim dhe mbrojtje. Kur një grup i arkitektëve dhe ekspertë konservimi në Suedi u mbledhën për të protestuar, u mbajtën edhe diskutimet për t'i gjetur mënyrat më të mira për të ndërmarrë hapa konkrete dhe për të sugjeruar propozime për financimin e ndihmës emergjente nga Suedia në këtë fushë, në kuadër të bashkëpunimit zhvillimor të Sida-s.

Brenda këtij grupi të anëtarëve themelues u përpiluan dokumentet dhe statutet e duhura për themelimin e fondacionit, qëllimet e të cilit u zgjeruan nga aksioni urgjent në ish-Jugosllavinë në “promovimin e konservimit të pronës kulturore në vendet e shkatërruara nga konfliktet e armatosura, katastrofat apo rreziqet tjera, si dhe në stimulimin e hulumtimeve të duhura”.

Çështja e të ndierit në shtëpi

E drejta për të pasur trashëgiminë kulturore vetjake është pjesë integrale e të drejtave të njeriut. Sot, një numër i madh i njerëzve nuk jetojnë në shtëpitë e tyre. Puna me trashëgimi kulturore paraqet një sfidë tmerruese.

Kohë pas kohë, ne jemi dëshmitarë të mënyrës se si lufta, konfliktet politike, fatkeqësitë natyrore, ndryshimet e klimës dhe neglizhenca ua mohojnë grupeve të ndryshme etnike të drejtën për trashëgimi kulturore dhe histori. Mënyra moderne e të luftuarit vazhdon të bëhet edhe më brutale në sulmet e saj ndaj popullatës civile, shembuj të pacipë të së cilës janë përdhosja dhe shkatërrimi i monumenteve të kulturës që i takojnë armikut. Kjo ka ndodhur në Ballkan, Lindjen e Mesme dhe Azi. Sidoqoftë, ka dëshmi të konsiderueshme të cilat provojnë se puna me konservim dhe zhvillim të ambienteve historike mund të promovojë procesin e pajtimit, forcojë vetëbesimin, kontribuojë në rritjen e zhvillimit dhe luftës së varfërisë.

Trashëgimia Kulturore pa Kufij u themelua në vitin 1995 si një organizatë suedeze joqeveritare që punon në frymën e Konventës së Hagës të vitit 1954 për mbrojtjen e pronës kulturore në rast të konfliktit të armatosur, fatkeqësive natyrore, neglizhencës, varfërisë apo konflikteve politike dhe sociale. Rindërtimi dhe mbrojtja e simboleve kulturore konsiderohet nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij si njëri nga kushtet që njerëzit të ndjehen si në shtëpi dhe të sigurt, posaçërisht pas luftës apo konfliktit në baza etnike.

Deri më tani, shumica e punës së kryer nga Trashëgimia Kulturore pa Kufij ishte e fokusuar në ish-Jugosllavinë me anë të restaurimit të objekteve, zhvillimin e muzeve dhe shkëmbim profesionistësh. Për më tepër, Trashëgimia Kulturore pa Kufij ka marrë pjesë në restaurimin e manastirit Tibetan në Gandze, në provincën Sichuan në Kinë.

Në të gjitha këto projekte prioritet i është dhënë përdorimit të materialeve dhe teknikave të njejta sikurse në objektin original dhe sigurimit që shumica e punëve të kryhen nga mjeshtërit lokalë.

Përderisa puna me trashëgimi kulturore ndihmon që grupet e viktimizuara të rikthejnë sensin e krenarisë së tyre, qëllimi ka qenë integrimi i restaurimit e zhvillimit kulturor në rrjedha të punëve ndihmëse emergjente e cila ndikon në krijimin e kushteve për pajtim dhe zbutje të varfërisë. Shpresë afatgjate është që edhe organizatat tjera ndërkombëtare të jenë të aftë për bashkëpunim për një mënyrë aq konkrete dhe praktike.

Dëshirojmë ti shprehim falënderimet tona të sinqerta gjithë përkrahësve tanë, donatorëve individual dhe Agjensionit për Bashkëpunim dhe Zhvillim ndërkombëtar të Suedisë (Sida) dhe BE, pa ndihmën e të cilëve asnjëra nga punët tona nuk do të realizoheshin...

Stokholm, Nëntor 2005

Bengt O. H Johansson (Kryetar)

**CH
WB**
Cultural
Heritage without Borders
KULTURAV UTAN GRÄNSER



**FONDACIONI PËR TRASHËGIMI
KULTURORE PA KUFIJ - SUEDI,
ZYRA NË KOSOVË**

adresa: R. Zogovic, Qyteza Pejton-10000 Prishtinë, Kosovë
tel & fax: +381 38 243 918
e-mail: kosovo@chwb.org
web: www.chwb.org, www.chwb.org/kosovo